



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
VSP
Prishtinë, më 20 dhjetor 2016

PROCESVERBAL

I VAZHDIMIT TË SEANCËS PLENARE, E MBAJTUR MË 20 DHJETOR 2016

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

Kryetari i njoftoi deputetët se nga seancat e mëparshme kanë mbetur disa pika të papërfunduara.

Ai procedoi me pikat e papërfunduara, si në vijim:

1. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e 1 (një) anëtari në Bordin e Ankesave të Komisionit të Pavarur për Medie

Kryetari i njoftoi deputetët se në seancën e mbajtur më 17 nëntor 2016 grupet parlamentare i kanë propozuar deputetët për kryetar, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 1 (një) anëtar në Bordin e Ankesave të Komisionit të Pavarur të Medieve.

Më pastaj, kryetari kërkoi nga GP i LVV-së që ta propozojnë zëvendëskryetarin e parë të komisionit, si dhe nga GP i LS-së ta propozojnë zëvendëskryetarin e dytë, ngase këto dy grupe parlamentare nuk i kishin propozuar anëtarët për këtë komision.

Pas propozimit të grupeve parlamentare, kryetari i hodhi në votim propozimet për formimin e Komisionin ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari në Bordin e Ankesave të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Kuvendi, me shumicë absolute, vendosi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari në Bordin e Ankesave të Komisionit të Pavarur të Medieve, në këtë përbërje:

1. Selville Halimi, nga GP i PDK-së, kryetare,
2. Mytaher Haskuka, nga GP i LVV-së, zv./kryetar i parë,
3., nga GP i LS-së, zv./kryetar i dytë,
4. Xhevahire Izma, nga GP i PDK-së, anëtare,
5. Armend Zemaj, nga GP i LDK-së, anëtar,
6. Blerim Grainca, nga GP i LDK-së, anëtar,
7. Lahi Brahimaj, nga GP i AAK-së, anëtar,
8. Zafir Berisha, nga GP "Nisma për Kosovën", anëtar dhe
9. Duda Balje, nga GP 6+, anëtare.

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 1 (një) anëtar të Bordit të Ankesave të Komisionit të Pavarur për Media duhet të veprojë në përputhje me nenin 11, paragrafi 2.3 të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për akreditim

Kryetari i njoftoi deputetët se në seancën e mbajtur më 30 nëntor dhe 1 dhjetor 2016 është përvjedhur një lëshim teknik në Projektligjin për akreditim. Në vend të 27 amendamenteve, në skenar ishin përfshirë vetëm 21 amendamente, të cilat edhe janë votuar.

Me vendim të Kryesisë, ky projektligj u riprocedua në tërësi.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi njëzëri i miratoi amendamentet prej 1-27 të Projektligjit për akreditim.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 59,
 Kundër ----- 0,
 Abstenime ----- 6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji për akreditim.

3. Votimi i raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015

Kryetari i njoftoi deputetët se për këtë pikë diskutimet kanë përfunduar në seancën e mëparshme.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 50,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 13.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti vjetor financiar i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015.

4. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar sipas kërkesës së deputetes Margarita Kadriu-Ukelli, e mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputet të tjerë nënshkrues lidhur me detyrimet e mundshme financiare të Kosovës për pretendimet e kompanive që kanë ushtruar padi në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit

Kryetari i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 17 nëntor 2016, por në mungesë të kuorumit nuk është proceduar më tej.

Rekomandimet e deputetes u janë shpërndarë deputetëve. Andaj, në seancën e sotme procedojmë me votimin e rekomandimeve të propozuara nga deputetja Margarita Kadriu-Ukelli.

Nuk pati kuorum të mjaftueshëm për të proceduar për votimin e rekomandimeve të lartshënuara.

5. Formimi i Komisionit hetimor parlamentar sipas kërkesës së deputetes Shqipe Pantina, mbështetur edhe nga 8 (tetë) deputetë të tjerë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me Radiotelevizionin e Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se edhe për këtë pikë diskutimet kanë përfunduar. Grupet parlamentare janë njoftuar për të paraqitur propozimet për këtë komision. Vetëm tri grupe parlamentare i kanë bërë propozimet për anëtarë edhe atë: GP i LVV-së, GP i AAK-së dhe GP “Nisma”.

GP i PDK-së, GP i LDK-së dhe GP “6+” nuk i kishin paraqitur propozimet për formimin e Komisionit hetimor parlamentar. Prandaj, nuk u procedua për votimin e kësaj pike.

Kryetari i mbylli punimet e seancës në orën 17:55.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*